



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SER. OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prijemno/Prodato Received/Delivery	08 - 04 2021	1	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	SKANSHEK	1697/2021	116



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.113/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën e datës 02.03.2021 me numër A.nr.113/2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë, Rr "Sali Nivica" objekti 89, kati-V-,nr.30 (afër banesave të bardha) Prishtinë, kundër Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës, në çështjen juridike "*Vlerësimi i rezultateve të punës*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 08.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET PJSËRISHT si e bazuar ankesa e datës 02.03.2021 me numër A.nr.113/2021 e parashtruar nga ankuesja

II.ANULOHEN Vlerësimet sipas formularit të datës 08.02.2021, i Drejtorit të Përgjithshëm në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës dhe rivlerësimi sipas formularit të vlerësimit i datës 23.03.2021 të pranuar, nga Drejtori i Përgjithshëm në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës.

III.DETYROHET Drejtori i Përgjithshëm në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës që të bëjë rivlerësimin e ankueses

IV.OBLIGOHET Drejtori i Përgjithshëm në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, që në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data pranimit të këtij vendimi, të ndërmerret të gjitha veprimet për zbatim të këtij vendimi.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja me datë 02.03.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 881/2021 e regjistruar me numër A.nr.113/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se Vlerësimi përfundimtar i punës për vitin 2020, i bërë nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, është jo real dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore, e cila me datë 12.02.2021 ka bashkangjitur mospajtimin e saj për Formularin për Vlerësimin e Rezultateve të Punës të

datës 08.02.2021, ku me datë 22.03.2021 përmes formës elektronike (E-mailit) ka kërkuar nga Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së vlerësimin përfundimtar, i cili me datën 23.03.2021 ka ftuar ankuesen në zyre dhe ja ka dorzuar formularin e Rivlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2020, duke i bërë ngritjen e notës së përgjithshme në tre (3), nga dy (2).

Ankuesja me datën 25.03.2021 përmes e-mailit ka njoftuar Këshillin lidhur me formularin e rivlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 24.03.2021, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses tek Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë 02.04.2021 ka pranuar përgjigjen, nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës, në kërkesë me numër protokolli:1600/2021, së bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesa A.nr.113/2021 e datës 02.03.2021 me numër protokolli 881/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes E-mailit; Formulari i datës 08.02.2021, për vlerësimin e rezultateve në punëve të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional; Mospajtim me vlerësimin e performancës për periudhën 22 qershor-31 dhjetor 2020 i datës 12.02.2021; E-mail i datës 22.02.2021; e-mail zyrtar i datës 12.02,2021; Vendim i datës 24.09.2020 me nr.53/2020; Vendimi i datës 04.11.2020 me nr.60/2020; e-mail i datës 14.10.2020; Vendimi i datës 19.08.2020 me nr.45/2020; Formulari për vlerësimin punës provuese i datës 15.05.2018; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë prej datës 1 janar -31 dhjetor 2018; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë prej datës 12.05.2020-22.06.2020; E-mail zyrtar i datës 15.11.2020; e-mail i datës 02.03.2021; Akt emërimi i datës 08.06.2018; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 16.03.2017; E-mail zyrtar i datës 02.02.2021; Vlerësimi final i performancës 23.03.2021; E-mail zyrtar i datës 12.03.2021; E-mail zyrtar i datës 31.03.2021; E-mail zyrtar i datës 29.03,2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm , i ulët dhe profesional; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit i datës 19.07.2019; Vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i datës 05.11.2020 me nr. A.nr.263/2020; Vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i datës 20.11.2020 me nr. A.nr.336/2020; Vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i datës 21.12.2020 me nr. A.nr.360/2020 dhe Përgjigje në ankesë e datës 02.04.2021 nga organi i punësimit bashkë me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtuara nga palët, ka konstatuar që ankesa pjesërisht është e bazuar dhe vendos që çështja të kthehet në **Rivlerësim, sepse:**

Bazuar në provat e lëndës respektivisht Akt emërimit e datës 08.06.2018 të ankueses rezulton se ankuesja ka themeluar marrëdhënie të punës në Autoritetin e Aviacionit Civil, në pozitë "**Drejtores e Departamentit për Administratë dhe Burime Njerëzore**", në bazë të përshkrimit të detyrave të punës i raporton Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon se vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2020, është nxjerrë jashtë afatit ligjor në kundërshtim me ligjin dhe aktet nënligjore, ku dhe është vlerësuar me notën e përgjithshme 1.8, me shmangie të administrimit të procesit të vlerësimit sepse ka pasur ndryshime të mbikëqyrësve të saj, në periudhat si në vijim: z. Eset Berisha nga 01 janar 2020 deri me datë 12 maj 2020, i shkarkuar me Vendimin nr.1/30 të

Qeveris të Republikës së Kosovës të datës 12 maj 2020, në periudhën nga 12 maj 2020 deri me 22 qershor 2020 z. _____ i emëruar ushtrues detyre sipas Vendimit nr.1/30 të Qeveris të Republikës së Kosovës të datës 12 maj 2020, dhe në fund periudha e z. _____ nga 22 qershor 2020, i emëruar sipas Vendimit nr.05/07 të Qeveris së Republikës së Kosovës. Po asntu, rivlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2020 i është bërë me ngritje të notës së përgjithshme në tre(3), pasi që ankuesja ka parashtruar mospajtimin e saj me shkrim më datë 12.02.2021 tek mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, kundër vlerësimit të datës 08.02.2021, e cila sipas pretendimit ankimor ka argumentuar me dëshmi se ka përmbushur dhe ka tejkaluar në tërësi të gjitha objektivat gjatë kryerjes së detyrave të punës për vitin 2020, dhe se vlerësimi si i tillë nuk është objektiv dhe i pabazuar në prova dhe fakte.

Bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik, i zbatueshëm nga data 09.07.2021 sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.ref.1583/20 të datës 09.07.2020 përkatësisht me nenin 2 paragrafi 3 është përcaktuar se: *“Nëpunës civil - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë”*, nga rrjedh se nëpunësit e Autoritetit të Aviacionit Civil, kanë statusin e nëpunësve civil, respektivisht me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, themelimi, ndryshimi, përfundimi i marrëdhënies së punës si dhe çdo e drejtë dhe detyrim nga marrëdhënia e punës për nëpunësit e Autoritetit të Aviacionit Civil, i nënshtrohen dispozitave të legjislacionit për nëpunësit civil.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon se vlerësimi përfundimtar i punës për vitin 2020 nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë, është jo real dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore, ka konstatuar se ankuesja në bazë të Formularit për vlerësim të rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i datës 08.02.2021 është vlerësuar me notën e përgjithshme 1.8 (një pikë tetë)dhe më datë 23.03.2021 përmes një formulari tjetër të vlerësimit ishte vlerësuar me notën 3.1(tre pikë një) dhe të dërguar ankueses më datë 24/03/2021 dhe se nga ky dokument /formular i vlerësimit konstatohet fakti se vlerësimet janë jashtë afatit ligjor të përcaktuar me legjislacion, dhe se nga këta dy formularë të vlerësimit të panënshtuar dhe të pa protokolluar është e paqartë se mbi çfarë baze ligjore janë bazuar këto dy vlerësime, pasi në të njëjtën kohë nuk mund të jenë me fuqi ligjore dy vlerësime pa pasur ndonjë akt administrativ përmes së cilit do të anulohet ndonjëri nga aktet.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar provat e lëndës të ankueses dhe organit të punësimit gjegjësisht Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, ka konstatuar se pretendimet e ankueses janë pjesërisht të bazuara sepse vlerësimi i datës 08.02.2021 për rezultatet e punës për ankuesen për vitin 2020 është nxjerrë jashtë afatit ligjor, nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë/ Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, në kundërshtim me nenin 43 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, ku përcaktohet se: *“... Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin paraprak”*, lidhur me nenin 8 paragrafin 2 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcaktohet se: *“ 2. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin paraprak”*, dhe si i tillë është i pa ligjshëm siç e përcakton dispozita ligjore e nenit 52 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“ 1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:.....1.3 është rezultat i shkëljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative”*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses me rastin e nënshkrimit të vlerësimit me datë 08.02.2021 të rezultateve të punës për vitin 2020, ka vepruar në kundërshtim me nenin 8 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcaktohet se: **“Vlerësimi përfundimtar i realizimit të objektivave dhe i aftësive profesionale të nëpunësit bëhet në fund të periudhës vlerësuese në bazë të një procesi, që përfshin: 1.1. takimi për diskutimin e realizimit të objektivave dhe rezultateve të arritura; 1.2. vlerësimin (notimi) e objektivave”**, sepse vlerësimi i është dërguar ankueses në kundërshtim me paragrafin 4 të nenit 8 i kësaj Rregullore, ku përcaktohet se: **“Formulari i vlerësimit siç përcaktohet në paragrafin 3 të këtij neni i dërgohet nëpunësit, i cili diskutohet në një takim me mbikëqyrësin dhe në afat prej 5 dite kalendarike nëpunësi duhet të shprehet (pajtohet ose nuk pajtohet) me vlerësimin e mbikëqyrësit”**, që në rastin konkret organi i punësimit nuk ka dëshmuar me asnjë provë se ankuesja është kontaktuar nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, për të diskutuar lidhur me periudhën e vlerësimit, dhe mbi këtë bazë ankuesja pasi ka pranuar vlerësimin, me datë 12.02.2021 ka paraqit me shkrim mospajtimin e saj, brenda afatit prej 5 ditëve, në pajtim me dispozitën e lartë cekur.

Bazuar në provat e lëndës Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses ka nxjerrë Rivlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2020 me notën e përgjithshme tre pikë një (3.1) të nënshkruar me datë 23/03/2021 dhe të dërguar ankueses më datë 24/03/2021, pa u bazuar në pretendimet e ankueses lidhur me periudhat e vlerësimit të punës me rastin e ndryshimit të mbikëqyrësve të saj, po ashtu ankuesja ka kontestuar të gjithë kapitujt e vlerësimit, sepse vlerësimi i rezultateve të punës i është bërë nga mbikëqyrësi jo kompetent për një periudhë të caktuar të vlerësimit, duke theksuar se mos përfshirja e arritjes së objektivave për ankuesen në bazë të detyrave të punës nuk është bazuar në raportet dhe aktivitetet e saj në punë, ku në vlerësim tek pesë (5) objektivat nuk janë përfshirë të gjitha aktivitetet, në bazë të provave, që është në kundërshtim me nenin 43 paragrafin 1, 2, 3,4,5,6 dhe 7, të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, duke u bazuar në përmbajtjen e vlerësimit të rezultateve në punë në kundërshtim me nenin 4 paragrafin 1, nënparagrafin 1.1, 1.2 pika 1.2.1 deri në 1.2.6 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcakton se: **“1. Vlerësimi i rezultateve në punë përmban: 1.1. matjen e realizimit të objektivave të përcaktuara - objektivat janë prioritetet e punës së nëpunësit dhe përfshijnë aktivitetet që duhen realizuar deri në fund të periudhës së vlerësuar; dhe 1.2. matjen e sjelljes profesionale të nëpunësit - sjelljet profesionale janë aftësitë profesionale të nëpunësit të treguara gjatë realizimit të detyrave dhe ushtrimit të përgjegjësive në punë, që përfshinë: 1.2.1. planifikimin dhe organizimin; 1.2.2. vendimmarrjen; 1.2.3. motivimin, zhvillimin dhe trajtimin e paanshëm; 1.2.4. iniciativën dhe kreativitetin; 1.2.5. komunikimin dhe përfaqësimin; dhe 1.2.6. efektivitetin në punë”**, andaj vlerësuesi/eprori aktual nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, sepse në bazë të provave të lëndës del se gjatë periudhës së vitit 2020, ankuesja ka pasur Mbikëqyrës të ndryshëm, dhe mbi këtë bazë ky i fundit, nuk i ka bërë vlerësimin e rezultateve të punës për ankuesen vetëm për periudhën kur ai ka marrë mandatin në këtë pozitë, nga data 22.06.2020 sipas Vendimit Nr.05/07 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, siç e përcakton dispozita ligjore e nenit 5 paragrafi 2 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcaktohet se: **“Nëse gjatë periudhës së vlerësimit, ndërrohet mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i nëpunësit para përfundimit të vlerësimit vjetor, ai vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse, ndërsa për periudhën e mbetur të vlerësimit vjetor, vlerësimi bëhet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt pasues”**, por ankueses i është bërë vlerësimi nga mbikëqyrësi i fundit edhe për periudhën kur nuk ka qenë eprorë gjatë vitit kalendarik duke mos ndarë periudhat sipas kohës së ushtrimit të përgjegjësive nga eprorët kompetentë, sipas formularëve të vlerësimit që gjenden në shkresat e lëndës, që është në kundërshtim me këtë dispozitë. Andaj, Kolegji mbi këtë bazë konstaton se ankueses duhet ti bëhet vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2020, nga mbikëqyrësit e saj, sipas periudhave përkatëse të menaxhimit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në prova dhe fakte të ankueses dhe organit të punësimit pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses ka vërtetuar se të njëjtat janë pjesërisht të bazuara, andaj eprori aktual është i obliguar që ankueses ti bëjë vlerësimin e rezultateve të punës, në pajtim me nenin 5 paragrafin 2 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike si dhe të ndërmerr të gjitha veprimet me qëllim që vlerësimi i ankueses të bëhet konformë legjislacionit që rregullon çështjen e vlerësimit të nëpunësve civil.

Mbi këtë bazë Kolegji me rastin e administrimit të provave konstaton se vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2020, ndaj ankueses është bërë në kundërshtim me metodologjinë e vlerësimit të rezultatit përfundimtar të përcaktuar në nenin 10 paragrafi 1,2,3 dhe paragrafi 4 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcakton se: **“1. Vlerësimi për arritjen e objektivave të punës përbën 60% të rezultateve përfundimtare të vlerësimit, ndërsa vlerësimi i sjelljeve profesionale të nëpunësve civilë përbën 40% të rezultateve përfundimtare të vlerësimit. 2. Nota mesatare e objektivave kalkulohet duke mbledhur notat e të gjithë objektivave të vlerësuar dhe duke pjesëtuar me numrin e objektivave të vlerësuar. 3. Nota mesatare e sjelljeve profesionale (aftësive) kalkulohet duke mbledhur notat e të gjithë aftësive të vlerësuar dhe duke pjesëtuar me numrin e aftësive të vlerësuar. 4. Nota e përgjithshme kalkulohet duke mbledhur 60% (shumëzuar me 60 dhe pjesëtuar me 100) të notës mesatare të objektivave dhe 40% (shumëzuar me 40 dhe pjesëtuar me 100) të notës mesatare të aftësive”**.

Kolegji si fakt vendimtar lidhur me shqyrtimin e ankesës, mori parasysh edhe faktin notor se viti 2020 ishte vit i përcjellë me situatën e pandemisë me COVID-19, dhe si rezultat i kësaj të gjitha institucionet publike kanë funksionuar me staf esencial dhe reduktime të stafit, rrethana këto që Kolegji vlerëson se kanë ndikuar në përmbushjen e objektivave të punës, andaj Kolegji bazuar në këto rrethana konstaton se Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses duhet të bëjë rivlerësimin e Rezultateve të punës për vitin 2020, duke marr parasysh të gjitha faktet e cekuar me lartë.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: **“Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës”**, dhe me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të po këtij ligji është përcaktuar se: **“Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit”**.


Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.113/2021, datë 08.04.2021

Sabile AVDYLI



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës ;
- Udhëheqësit të Personelit në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së .

